

## **Njoftim për medie: Të çrrënjoshim punën e kryer nga fëmijët 2021-Koha për të kaluar nga zotimi në vepra!**

2021 është Viti Ndërkombëtarë për Eliminimin e Punës së Fëmijëve, sic është deklaruar nga UN Resolution 73/327. ILO fasilton organizimin dhe koordinimin global të aktiviteteve gjatë këtij viti, së bashku me Alliance 8.7 dhe partnerët e saj.

Ky vit është një mundësi për përshpejtimin e masave drejt arritjes së objektivit të Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm për t'i dhënë fund punës së fëmijëve deri në vitin 2025, dhe për t'i adresuar sfidat e imponuara nga COVID-19. Ky vit poashtu do të shërbej për të ndërtuar një momentum drejt Konferencës V Globale për Luftim të Qëndrueshëm të Punës së Fëmijëve, në vitin 2022.

Strategjia për Vitin Ndërkombëtarë bazohet në tre shtylla **Vepro, Inspiro dhe Zgjerije veprimin.**

Institucionet dhe organizatat që i janë bashkuar nismës globale, duke përshpejtuar masat për parandalimin dhe luftimin e punës së fëmijëve janë Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (MESTI), Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Edukimit dhe Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtje të Fëmijëve, të cilat kanë bërë zotimet e tyre në platformën #endchildlabour2021. Nga ana tjetër, Ministria e Financave Punës dhe Trasfereve ka përshpejtuar masat për përditësimin e kuadrit ligjor dhe përgatitjen e Procedurave Standarde të Veprimit për Fëmijët në Punë, në mënyrë që të përmirësohet reagimi ndaj rasteve të punës së fëmijëve, që viktimat të mbrohen nga viktimizimi sekondar dhe të inkurajohen, të sigurohen e të fuqizohen për t'u mbrojtur nga puna e rrezikshme dhe të ri-integrohen në shoqëri.

Arritjet kryesore dhe prioritetet për vitin 2021 do të prezantohen në **Webinarin “Jepi fund punës së fëmijëve 2021- Koha për të kaluar nga zotimet në veprim!” që do të mbahet më datë 11 qershor (e premte) nga ora 12:30.** Folësit kryesorë janë Sh.S. Arbërie Nagavci - Ministre e MASHTI, Z. Imri Demelezi - Zëvendës Ministër i MBPZHR, Z.Mentor Morina - Drejtor i Departamentit për Politika Sociale dhe Familje, Z. Rrahman Jashari - Kryetar i SBASHK dhe Z. Berat Rukiqi-Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës. Një adresim do të kemi edhe nga Znj. Ulrika Richardson, Koordinatore e KB për Zhvillim dhe Znj. Laurence Dubois, Drejtoreshë e Projektit të ILO-së MAP 16, ndërsa Znj. Lindita Boshtrakaj, Koordinatore e Projektit të ILO-së MAP 16 në Prishtinë do të moderoj takimin.

**Për të marrë pjesë në këtë ngjarje ju lutem regjistrohuni në këtë [link](#).**

Kjo ngjarje është pjesë e projektit projektit “Masat, ndërjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përshpejtimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) Caku 8.7, që financohet nga Departamenti i Punës i SHBA-së.

**Pa angazhimin tuaj në zbatimin e këtyre prioriteve, puna e fëmijëve nuk mund të eliminohet!**

**Së bashku, le ta shfrytëzojmë këtë mundësi që të gjitha vajzave dhe djemve t'u sigurojmë një të ardhme pa punë të fëmijëve!**